



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË



Datë: 24.03.2023

137/23

Drejtoria Komunale për Arsim

Mrfaq/Brshr

289

Datë/Datum

24.03.2023

Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, Qershor 2088), nenit 47 pika c). Të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr. 98 datë: 30.07.2012, nenit 2, 3 dhe i Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr.83 e datës 14.06.2013, dhe në mbështetje të vendimit me nr. 301 të datës 22.03.2023, aprovuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 24.03.2023 shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për ndarjen e ndihmës momentale për studentë të Komunës së Fushë Kosovës dhe ndihmës momentale për nxënësit me nevoja të veçanta të Komunës së Fushë Kosovës

I. Komuna e Fushë Kosovës ndanë ndihmë momentale për studentët e Komunës së Fushë Kosovës për vitin akademik 2022/23 në të gjitha fushat e studimit.

II. Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët/nxënësit që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës pa kurrfarë dallime etnike, gjinore, fetare dhe politike.

III. Kategoritë e përfituesve janë :

1. Studentet- bachelor, master dhe doktoraturë (përparësi kanë studentët me dege deficitare : teknike, shkenca natyrore matematikore, mjekësi, arkitekture etj, edhe nën notën mesatare 7.0)
2. Studentet- studime jashtë vendit;
3. Studentët- studime postdiplomike;
4. Trajnerët dhe mësimdhënësit me projekte në ngritje të cilësisë në kurrikulë, plan individual dhe të ngjajshme;
5. Nxënësit me nevoja të veçanta;
6. Fëmijët/nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta;
7. Nxënësit- Bartja (transporti) i nxënësve për fushat e arsimit të obliguar të cilat nuk ofrohen në komunën tone.

IV. Kriteret e përgjithshme për ndarjen e ndihmës momentale janë:

1. Të ketë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet ndihma momentale;
2. Nota mesatare e studimeve mbi 7.0;
3. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi);
4. Për studentët në studime jashtë vendit-dëshmi nga universiteti ku studion;
5. Për nxënësit me nevoja të veçanta- dëshmi vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
6. Fëmijët/nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta: dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT.



V. Kriteret për ndarjen e ndihmës momentale për studentët:

1. Të ketë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet ndihma momentale;
2. Nota mesatare e studimeve mbi 7.0;
3. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi);
4. Për studentët në studime jashtë vendit-dëshmi nga universiteti ku studion;

Dokumentet e domosdoshme për aplikim :

- Aplikacioni sipas formës së komunës (e gjeni të publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Kopja e ID-së së studentit;
- Vërtetimi se studenti ka të regjistruar vitin akademik 2022/23 (origjinale);
- Certifikata e notave (origjinale);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Deklarata e bashkësisë familjare (për studentet që janë dy e me tepër, nga një familje);
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

VI. Kriteret e përfitimit për nxënës me nevoja të veçanta :

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës- dëshmi letërnjoftimi
2. Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i Komunës së Fushë Kosovës;
3. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Formulari për aplikim (e gjeni te publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Certifikata/ekstrakti i lindjes së fëmijës ;
- Letërnjoftimi i prindit;
- Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

VII. Kriteret e përfitimit për transportin e nxënësve për fushat e arsimit të obliguar të cilat nuk ofrohen në komunën tone:

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës
2. Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Formulari për aplikim (e gjeni te publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Certifikata/ekstrakti i lindjes së fëmijës;
- Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;
- Letërnjoftimi i prindit;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.



VIII. Kriteret e përfitimit për trajnerët me projekte në ngritje të cilësisë në kurrikulë dhe plan individual për mësimdhënës:

1. Të jetë i certifikuar nga MASHT, në njërin nga këto trajnime: ngritje të cilësisë në kurrikulë, plan individual dhe trajnimi për ekipin për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Formulari për aplikim (e gjeni te publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Përshkrimi i projektit;
- Letërnjoftimi;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

Vërejtje: Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Thirrja mbetet e hapur 15 dite pune nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve në faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/category/shpalljet/konkurset/>

Konkursi mbetet i hapur nga data 24.03.2023 deri me date 07.04.2023

Drejtori i DKA- së
Fadil Krasniqi

